

**Raport për punën e
IPK Kopshti i Fëmijëve “OLLGA MICESKA”
Kërçovë**

për vitin shkollor 2019-2020



**Shtator 2019-Gusht 2020
Kërçovë**

1. HYRJE

Raport për punën në IPK- Kopshti fëmijëve “ Ollga Miceska” Kërçovë për vitin shkollor 2019/2020 paraqet dokument në të cilin janë përfshirë të gjitha aktivitetet të parapara me programin vjetor dhe realizimin e tyre.

Si pjesë e vetme e sistemit edukativo – arsimor, edukimi dhe arsimimi parashkollor i vërtetuar me Ligjin për mbrojtje të fëmijëve, Ligjin për edukim dhe arsimim të fëmijëve të moshës parashkollore që është një proces i ndërlikuar dhe kompleks. Ajo është një periudhë në të cilin formohet bazat kualitative të personit prej kujt mvaret edhe zhvillimi i mëtutjeshëm i njeriut të ardhshëm.

Nëpërmes raportit shkurtimisht do ti paraqesim të gjitha aktivitetet të cilët janë të paraparë me planin vjetor por edhe të realizuara. Ato aktivitete janë: përfshirja e fëmijëve, angazhimi i personelit edukativo – kujdesës për realizimin e veprimtarisë, kushtet tekniko materiale, mbrojtja shëndetësore, ushqimi, higjiena, realizimi i programit edukativo – arsimor, bashkëpunimi me prindërit, bashkëpunimi shoqëror, aktiviteti i hapur kulturor, bashkëpunimi me organet profesionale dhe të ngjashëm.

2. BAZAT KALUESE PËR REALIZIMIN E VEPRIMTARISË

Dijenitë bashkëkohore të shkencës dhe arritjet psikologjike dhe pedagogjia, si dhe shkencatë tjera disiplinoretë ngjashme, tregojnë se mosha parashkollore është periudhë e zhvillimit intensiv të fëmijëve, ajo është periudhë në të cilën formohen bazat kualitative të personit, prej kujt mvaret zhvillimi i mëtutjeshëm i personit të ardhshëm.

Plani vjetor është i konceptuar sipas Ligjit për mbrojtjen e fëmijëve, Ligjit për familjet, respektimit të konventave për fëmijët, si dhe të drejtës kushtetuese dhe obligimit të institucionit, që ta programojë punën e vet, dhe ajo mendohet se është baza për programimin e punës, për arritjen e rezultateve më kualitative për realizimin e veprimtarisë, si dhe futjen e nevojës për transformim të organizimit parashkollor, futjen e ndryshimeve e planifikimeve dhe programimeve të punës dhe realizimin e kujdesit të programit edukativo – arsimor.

Prezent është nevoja për multiciplimin e formave dhe përmbajtjeve që do të thonë përfshirjen e brezave të rinj në më shumë sekuenca (qëndrim tërë ditë në kopsht, gjysmë ditë dhe të ngjashëm sipas nevojës dhe kërkesave të prindërve);

Në procesin e organizimit edukativo – arsimor dhe punën e kujdesit, nisemi nga fëmija si person që ka aftësitë e veta, dijeni, shprehi, dhe qëndrime. Nisur nga dijenitë pedagogjike - psikologjike për zhvillimin e fëmijës, që ndikohej në zhvillimin fizik, social, emocional dhe zhvillimin social dhe intelektual të fëmijës.

Fazat kaluese për organizimin e veprimtarisë dalin edhe nga qëllimet dhe detyrat e edukimit dhe arsimit parashkollor, cilat qëllimet dhe detyrat ishin lëndë realizimin e programit 2019/2020 dhe ato ishin: ta kultivojë, inkuadrojë, drejtojë dhe fisnikërojë në zhvillimin e gjithanshëm të fëmijës dhe personit të përshtatet me karakterin psikofizik dhe mundësitë individuale të fëmijës.

Qëllimet praktike dhe detyrat e përfshira me program ishin lëndë për realizimin e vitit shkollor në vijim dhe bëhej përpjekje të rinjtë që të sigurohet drejt:

- a)zhvillimi fizik dhe senzomotorik i fëmijëve,**
- b) zhvillimi social – emocional të fëmijëve dhe**
- c)zhvillim intelektual – ndërgegjestë fëmijëve.**

a) Zhvillimi fizik dhe senzomotorik të fëmijët të zhvillohet edhe atë:

- të mundësohet rritje normale dhe zhvillimin e organeve dhe funksionimin e tyre,
- ta forcojë shëndetin trupor të fëmijës dhe ta mbrojë prej sëmundjeve dhe lëndimeve,
- të nxis zhvillimin e aftësive të lëvizjeve dhe përballimin e motorikes.
- ta drejtojë krejt zhvillimin senzomotorik,
- ti zhvillojë shprehitë bazë për mbajtjen e higjienës trupore, marrjen e ushqimit si dhe kryerjen e nevojave fiziologjike.

b) Zhvillimi social – emocional:

- të fëmija të ndikohet në mënyrë graduale të zhvillohet ndjenja për sjellje individuale dhe nevoja për kontakte me të tjerët,
- ta përkrahin drejtpërdrejtë dhe me sinjeritet fëmijën në kontakt me botën,
- të sigurohen kushte që të formohenfëmijë të lumtur dhetë kënaqur.
- të kontribuohet për pavarësi dhe për vetëbesimtë fëmijës,
- ta nxis fëmijën kah individualiteti dhe përjetimet e përbashkëta të aktiviteteve,
- t'i ndihmohet fëmijës në përvetësimin e rregullave elementare për sjelljen me moshatarët dhe të rriturit.

c) Zhvillimi social – intelektual:

- ta nxis dhe përkrah kuriozitetin natyral të fëmijës për botën që e rrethon,
- të kultivojë ndjeshmërinë e fëmijës për pranimin e mbresave (pershtypjet e para),
- të nxisin komunikimin e bisedave të fëmijës dhe dalëngadalë ta pasurojë zhvillimin e vet,
- ta drejtojë zhvillimin e aftësisë së perceptimit dhe senzomotorikën e fëmijës,
- ta nxis zgjidhjen e problemeve të vogla për inteligjencën senzomotorike,
- të japin kushte të favorshme për formimin e dijenive të volitshme, kuptim për aktivitetet praktike të fëmijës.

3. ORGANIZIMI, REGULLIMI I MBRENDSHËM DHE KUSHTET PËR PUNËN E KOPSHTIT

a) Kushtet hapësinore

Veprimtaria mësimore e vitit 2019/2020 realizohej në të 4 objektet.

Objekti amë “Ollga Miceska” shfrytëzohej maksimalisht me kapacitet të plotë; Objekti klon “Lulishtja” punonte me kapacitet të zvogëluar; Objekti klon „Dallëndyshja” me kapacitet të plotë dhe objekti në komunën e Plasnicës vetëm me një grup.

Të katër objektet janë ndërtuar me material të fortë dhe të njëjtit i përgjigjen veprimtarisë e cila realizohet në pajtim me normat ligjore. Hapësirat janë të ndara me dyer (harmonika) dhe përmbahen për zbavitje dhe dhoma e gjumit e përshtatshme për pushim ditor.

b) Sipërfaqja e oborrit i të katër objekteve janë mjaftë funksional, të gjelbëruar dhe të mbjellur me dru të gjelbër. Sipërfaqja e oborrit të objektit amë është 4000 metër katëror, sipërfaqja e objektit “Lulishtja” është 4.275 metra katëror, sipërfaqja e oborrit të objektit “Dallëndyshja” 2800 metra katëror ndërsa në objektin e komunës së Plasnicës oborri është i përbashkët me shkollën.

Sipërfaqet e oborrit të gjelbëruar shërbejnë për shëtitje të fëmijëve dhe për lojëra të lira dhe të tjera veprimtari.

c) Këndet e punës të fëmijëve që organizohen në çdo qëndrim dhe të njëjtit janë të pajisur me materiale didaktike dhe çdo fëmijë e gjen vendin e vet në atë vend pune.

d) Në lidhje me shkallën e pajisjes disponohet me mjete audio vizuale dhe materiale të tjera ndihmës, siç janë: vizuale, auditive, audio vizuale, manipulative si dhe mjete për tu shprehur.

Mjetet vizuale : aty bëjnë pjesë mjetet që fëmijët i përdorin me ndihmën e shqisës së pamjes. Baza funksionale e këtyre mjeteve është që të shfrytëzohen për shikim sistematik dhe në kornizat e aktivitetit drejtues mundëson që fëmijët të pajisen me kuptim për krejt atë që e rrethon.

Prej grupit tredimensional të mjeteve vizuale i shfrytëzojmë : lodrat, objekte natyror, maketet, mjete të komunikacionit, shenja, tabela magnetike dhe të tjera, kurse në grupin dydimensional të mjeteve vizuale përdorim : pikturat, fotografitë, posteret, ilustrimet tematike dhe të tjera.

Në lidhje me mjetet auditive, këto mjete kontribuojnë me ndihmën e shqisave për dëgjim ta zbulojnë të vërtetën objektive, ti përjetojnë tingujt muzikor, dhe të sigurojë orientim auditiv dhe komunikim në jetë. Këtu bien inçizime të ndryshëm me karakter reprodutiv siç janë : zhurmat, tonet, tonet jehuese të natyrës, zërat, fjalët, dramatizimi, këndimet muzikore të

zogjve dhe të ngjashme. Me ndihmën e incizimeve të dukurive akustike të natyrës fëmijët më mirë e njohin mesin natyror nëpërmes kasetofonit.

Mjetet audio vizuale i bashkojnë pikturat, fjalët, lëvizjet ndikojnë njëkohësisht në zhvillimin e perceptimit për shikim dhe dëgjim me të cilën kontribuohet për shumë anësi të realizimit të programit edukativo – arsimor të punës.

Mjetet për shprehje, siç janë : instrumentet muzikor me goditje,(dajre, baraban, ksilofon, çinela) i stimulojnë fëmijët dhe me ndihmën e tyre kryejnë aktivitet ritmike të ndryshëm dhe motorik.

d) Literatura profesionale – revista për fëmijë (shkalla e furnizimit dhe shfrytëzimi i tyre).

Sa i përket literaturës profesionale mundet të thuhet se disponojmë në masë të duhur për realizimin e përmbajtjes programore të punës edukativo arsimore. Për atë qëllim zbatim të madh kanë doracakët “ Fëmijëria dhe lojnat” dhe “ Planifikimi tematik me përvojë praktike”. Po ashtu disponojmë me tekste dramatike, tregime, përralla, vjersha dhe kallëzime.

Prej revistave disponojmë me : Prosvetno dello, Prosveten rabotnik, Semejstvo, Vospitni krstopati, Ekologjia, që shumë ndikojnë në specializimin e personelit.

Prej revistave për fëmijë marrim Rosica. Kjo revistë është me karakter profesional edukativ dhe tërësisht është e shfrytëzuar. Përmbajtjet që janë të përfshira janë aktuale dhe të shprehura me kolorit të ndryshëm në korrelacion me programin mësimor që jep mundësi për vetëkritikë dhe vetëbesim.

e) Në objektin amë Ollga Miceska dhe në objektin klon Lulishtja është realizuar renovimi i hapsirave të mbrendshme të objekteve ,ngjyrosja e mureve rregullimi i sistemit elektrik. ndërrimi i dyshekëve, ndërrimi i tepisonave dhe rregullimi dyshemeve. ndërrimin e perdeve, në objektin klon Lulishtja është bërë ndërrimi i dy dyerve kryesore dhe ndërrimi i dyerve dhe dritareve në bajno, rregullimi i dyshemeve ,ndërrimi i tepisonave si dhe shënimi i këmbësorve me vija të bardha para objektit dhe furnizimi i kuzhinës me paisje të reja.

Objekti i ri Dallëndyshet është paisur me tepisona dhe është bërë ngjyrosja e mureve, vendosja letër muri si dhe vizatimi i mureve me figura të ndryshme për fëmijë, ngjyrosja e pllakave të betonit me ngjyra të ndryshme si dhe figura për fëmijë me numra, shkronja dhe lojra të ndryshme nëpërmjet figurave për fëmijë ,rregullimi dhe dekorimi i oborreve është bërë në të tre objektet paralel nga ana e personelit si dhe nga ana e prindërve.

Në objektin amë është bërë lyreja e fasadës me ngjyra të ndryshme dhe është realizuar ndërrimi i dritareve, ndërrimi i plakave në koridorin e fëmijëve ,vendosja e paravaneve në tualet të fëmijëve, vendosje e komodave për mbajtjen e sendeve personale të fëmijëve.

Me shfrytëzimin e një donacioni që është bërë për kopshtin tonë është krijuar “Dhoma sensorike” për fëmijët me nevoja të veçanta.

Në objektin amë është renovuar dhe paisur me mjete dhe lojra për fëmijët dhoma e kujdestarisë poashtu është renovuar me tvolinë pune dhe karrike të reja zyra e drejtorit edhe në zyrën administrative është montuar komodinë për sistematizimin e dosjeve, arkivit dhe të gjithë dokumentacionit të Kopshtit të fëmijëve “Ollga Miceska” Kërçovë.

Gjithashtu kopshti i fëmijëve u paisë me makinë të re për transportin e ushqimit.

Janë ndërruar të gjitha karriket e vjetra në dhomat e qëndrimit të fëmijëve, janë rindërtuar të gjitha tavolinat në dhomën e ngrënies, është renovuar komplet toaleti i personelit. Rregullimi i terasave me beton të ri gjithashtu është bërë ngjyrosja e tërë konstruksionit prej hekuri. Është shtruar rërënë këndin e lojrave në oborr dhe rregullimi i tërë konstruksionit prej druri dhe ngjyrosja e tyre dhe gjithashtu janë vendosur luhatëse të reja. Është rregulluar hyrja me pllaka

sanitare . Gjithashtu janë renovuar dhe pasuruar paisjet e kuzhinës-janë siguruar tenxhere, pjata dhe lugë të reja. Poashtu nga një donacion janë siguruar pastrues të ajrit në të gjitha hapsirat e kopshtit ku qëndrojnë fëmijët.

Me rastinin e vitit të ri 2020 Kryetari i Komunës së Kërçovës siguroi 330 paketa dhurata për fëmijët që qëndrojnë në kopshtin tonë, gjithashtu edhe drejtori i Tec Osllmej siguroi paketa dhe donator nga bizensi privat .

4. ORGANIZIMI I PUNËS GRUPET E ÇERDHE, DHE KOPSHTIT

a) Organizimi i jetës dhe puna në çerdhet e fëmijëve

Në çerdhet janë përfshirë fëmijë prej 9 muajsh deri në 2 vjet. Si moshë më vogël e fëmijëve u mundësohen kushte për zhvillim të drejtë, mes edukativ, qëndrim edukativ për lojna material i zgjedhur edukativ për lojna, ushqim adekuat, mbrojtja shëndetësore dhe higjiena.

Detyra kryesore në veprimtarinë edukativo – brengosësh është ruajtja, nxitja, drejtimi, zhvillimi dhe fisnikërimi spontan i aktivitetit të fëmijëve duke respektuar individualitetin e tij.

Në qendrën tonë funksiononte një grup i kombinuar dhe atë prej 9 – 24 muajsh.

- Rregullimi i hapësirës është një segment me shumë vlerë dhe domethënie të madhe për zhvillimin e fëmijëve. Ajo bëhet edhe më tutje në përputhshmëri me Normativin. Kjo moshë e fëmijëve është specifike dhe kryehen një mori aktivitete në hapësirën nëpërmes: zhegjitjes, tërheqjes, rrëshqitjes dhe të tjera. Fëmija kryen shumë manipulime në hapësirën dhe i mundësohet liria maksimale në hapësirë. Për atë qëllim rregullimi i hapësirës është një ndër komponentët si dhe rregullimi përjashta hapësirës (hortikultura dhe tarracat) ku vocërrakët dalin në ajër të pastër.

- Pranimi i fëmijëve në çerdhe bëhet vetëm për fëmijë të shëndoshë dhe me dokumentacion të plotë. Pranimi i fëmijëve në mëngjes bëhet nga motra medicinale dhe e njëjta bënë edhe një bisedë të shkurtër për gjendjen shëndetësore të fëmijëve dhe ashtu vjen në dijeni për gjendjen shëndetësore të fëmijëve.

Orari i aktiviteteve gjatë ditës dhe të nesërmen:

- Pranimi i fëmijëve.....prej 6,00 deri 8,30 orës
- ndërrimi i pelenave.....7,00 - 8,00 "
- Aktivitetet e mëngjesit..... 8,00 - 8,15 "
- ushqim.....8,10 - 8,45 "
- lojna me fëmijët.....8,45 - 9,15 "
- kafjall.....9,15 - 9,30 "
- lojna në ajër.....9,30 - 10,00 "
- kontroll i pelenave.....10,00 - 10,30 "
- përgatitje për ushqim.....10,30 - 11,00 "
- dreka.....11,00 - 11,30 "
- përgatitje për pushim dhe fjetje.....11,30 - 13,30 "
- ndërrimi i teshave.....11,30 - 14,00 "
- kafjalli i dytë.....14,00 - 14,30 "
- lojna dhe përcjellje në shtëpi.....14,30 - 17,00 "

Gjatë vetë pranimit në mëngjes të fëmijët e vegjël jepet një atmosferë e këndshme kurse ajo është pasqyrim i të punësuarit në çerdhet e fëmijëve. Hapësira ku janë të vendosur fëmijët e vegjël është e pastër, e ajrosur dhe ajo bëhet për çdo ditë nga ana e përgëdhelseve dhe përgjegjëseve të mbajtjes së higjienës. Gjumi i fëmijëve me doemos të jetë i qetë dhe i thellë dhe zgjimi bëhet gradualisht.

Aktivitetet edukative të kësaj moshe realizohet nëpërmes të llojllojshmërisë së lojnavë funksionale – didaktike, konstruktive, të lëvizshme me të cilën mundësohet zhvillimi i lëvizjes, të folurit dhe të ngjashme.

Lojnat e lira dhe qëndrimi në ajër marrin pjesën më të madhe gjatë tërë ditës a me të kontribuohet në ruajtjen e shëndetit të fëmijës dhe sigurimit më të këndshëm të qëndrimit.

Sa i përket higjienës në hapësirën ku qëndrojnë këto fëmijë të vegjël për çdo ditë kryhet pastrimi dhe dezinfektim i mobilieve, lodrave, oturakëve dhe të tjerave.

b) Organizimi i jetës dhe puna në kopshtin e fëmijëve

Në fazën e raportimit, organizimi i jetës dhe punës në kopshtin shpalos kryesisht organizimin e aktiviteteve të lidhura me jetën e përditshme dhe nevojat e jetës, si dhe procesin e lojnavë, aktivitetet e punës dhe mësimin. Me organizimin e këtyre aktiviteteve fëmijëve u mundësohet adaptim më i lehtë në mes, formojnë vetëbesim dhe siguri më të madhe. Zgjidhet përmbajtja që do të kontribuojë në zhvillim tërësor të fëmijëve parashkollor.

Veprimtaria edukativo arsimore në kopsht përfshin punën e tërësishme me fëmijët gjatë ditës. Për çdo ditë pune përgatitet orar orientues të aktiviteteve dhe atë fillon në ora 6,00 dhe deri në përcjelljen në ora 17,00.

- Rregullimi i hapësirës ishte punë e përditshme e përgjegjësve që sa më racionale të përdoret në brendi dhe jashtë. Mirë e rregulluar hapësira mundëson atmosferë të këndshme dhe atë pa pengesa rrjedhën e veprimtarisë.

- Formimi i grupeve bëhet në fillim të vitit shkollor dhe atë sipas moshës siç vijon:

- 2 – 3 vjet.....12 – 15 fëmijë
- 3 – 4 vjet.....15 – 18 fëmijë
- 4 - 5 vjet.....18 – 20 fëmijë
- 5 – 6 vjet.....20 – 25 fëmijë
- 6 vjet përkatësisht prej shkuarjes në shkollë – 10 vjet.....20 – 30 fëmijë

Me këtë mënyrë të organizimit të jetës të veprimtarisë edukativo – arsimore, këto organizata të këtij lloji ofrohen më afër kushteve natyrore të jetës së fëmijëve dhe më lehtë kyçen me moshatarët me më të vegjlit dhe shokët e mëdhenj.

-Pranimi i fëmijëve bëhet për çdo ditë, duke filluar nga ora 6,00, atë e bënë motra e medicinës dhe menjëherë i dërgon fëmijët te grupet që i takon. Pranimi i fëmijëve është komponentë kryesore për atë që fëmijët vijnë prej meseve të ndryshëm. Fëmijët vijnë me përvoja të ndryshme sociale dhe i njëjti vjen në një mes të organizuar ku të gjitha aktivitetet janë të parapara dhe të organizuara.

Veprimtaria e edukimi arsimor në periudhën e kaluar rrjedhke nëpër aktivitete të llojllojshëm edukativo – arsimor. Ajo organizohej nëpërmes tri formave të punës edhe atë:

1. Aktivitete të lira – si formë e veçantë e ndikimit edukativ.
2. Aktivitete drejtues – si formë e ndikimit jo të drejtpërdrejtë, udhëheqje, drejtim dhe ndjekje të zhvillimit të fëmijës.

3. Aktivitetet e jetës – si formë e kënaqësive të nevojave të fëmijës për ushqim, pushim, mbajtja e higjienës dhe të ngjashme.

5. REALIZIMI I PROGRAMIT PËR PUNËN EDUKATIVO - ARSIMORE

Plani vjetor për punën në kopshtin e fëmijëve

Programi është i konceptuar sipas Ligjit për edukim dhe arsimin parashkollor. Ligji për mbrojtjen e fëmijëve si dhe për nevojat e Qendrave të rregulluara me të drejtat dhe obligimet e IPK – Kopshti i fëmijëve të programojë punën.

Plani vjetor është dokument bazë ku konkretizohen qëllimet bazë dhe detyrat të qendrave parashkollore, procedimet, mënyrat, mjetet që mundësojnë arritjet e rezultateve optimale në procesin edukativo – arsimor si dhe ndjekjen dhe vlerësimin e arritjeve të rezultateve.

IPK – Kopshti fëmijëve “ Ollga Miceska” për punën e vet për çdo vit përgatit program për punë në të cilin është përfshirë i tërë aktiviteti. Në raportin e periudhës së mëparshme aktivitetet e parapara janë realizuar.

Me plani vjetor parashihen aktivitetet që sjellin për realizimin e qëllimit të përbashkët të të vetmit sistem edukativo – arsimor në shtetin tonë, dhe ajo është formimi i lirive, zhvillimi i gjithanshëm i personit krijues.

Puna edukativo – arsimore në vitin e kaluar shkollor 2019/2020 janë realizuar veç e veç në çdo grup edukativ.

a) Karakteristikat e realizimit të punës edukuese në çerdhen e fëmijëve

Çerdhet si formë brengosësh në periudhën e kaluar funksiononin si një grup ku ishin të përfshirë fëmijët prej 9 muajsh e deri në 2 vjet. Në këtë grup ishin përfshirë fëmijë të moshave të ndryshme dhe për të gjitha kujdeseshin motrat medicinale pedagogjike, të cilat kanë përgatitur orar ditor për aktivitetet me të cilët mundësohet edukimi i caktuar me ritëm të aktiviteteve fëmijëror dhe organizim i drejtë edukativo – arsimor dhe metodologjik.

Edukimi – arsimor metodologjik përgëdhelseve u ofron që të japin mes të sigurt, të shëndosh, e cila stimulon, të bashkëpunojnë me prindërit dhe me të tjerë profesionist. Ai mes është dinamik, përherë ndryshon, në të cilin fëmijët pajisen me përvojë që përgjigjet për zhvillimin e jetës së tyre. Për atë qëllim individualiteti kërkon prej personelit edukativ – brengosësh që të japin aktivitetet që të bëjnë çdo fëmijë të ndihet i suksesshëm. Loja është zemra e mirë e metodologjisë edukativo - arsimore për fëmijët parashkollor dhe ajo është pjesë me vlerë e jetës së fëmijëve. Për atë qëllim në hapësirën ku qëndrojnë fëmijët duhej tu ofrohej përherë mundësi për lojnat të lira. Loja bëhet në shumë mënyra : kur fëmija luan vetë me lodrat, loja asociative me fëmijët tjerë, loja aktive – dramatike loja me rekuizita.

Timi edukativo – arsimor ishte përherë i përgatitur që ta zgjerojë dhe pasurojë lojën dhe me të nxisnin fëmijët që të mendojnë. Metodologjia edukativo – arsimore për fëmijë e çerdhes dhe të moshës dy vjeçare u ofron përgëdhelseve këshillim praktik si ti përkrahin motivet, sociale, zhvillimin e të folurit dhe zhvillimin psikofizik të fëmijëve.

b) Nota profesionale për shkallën e realizimit (me rezultate të kënaqshëm, paraqitja e dobësive, rezultate të posaçëm dhe të ngjashëm) në vitin shkollor 2019/2020 të zonës:

- Shprehitë kulturo – higjienike

- Shprehitë punuese – edukative
- D N SH M
- Kultura e të folurit
- Hyrje në matematikë
- Edukimi arti
- Edukim muzikor
- Edukimi fizkulturë – shëndetësore

Me planin vjetor janë përpunuar detyra dhe përmbajtje prej të gjitha lëmenjve të lartë përmendura. Programi paraqitet pas planeve vjetore për punën në grupet edukative, kurse edukatorët gjatë përgatitjes së planeve të vet vjetor dhe mujor i respektojnë mundësitë dhe moshën e fëmijëve në grupet edukative, si dhe kushtet dhe mundësitë në kopsht.

Planifikimi ka qenë tematik, por ajo nuk do të thotë se me planifikim tematik mundësohet krejtësisht qasje tjetër për punën edukativo – arsimore . Në planifikimin tematik në plan të parë janë interesat e fëmijëve ku dhe fëmija është venduar në qendër të procesit edukativo – arsimor. Me këtë planifikim nuk ka kufi të ashpër në mes të zonave edukativo – arsimore. Me këto planifikime jo vetë që jepet mundësia për qasje individuale për çdo fëmijë por edhe më lehtë i përvetësojmë interesat dhe dëshirat e fëmijëve.

Në vitin shkollor 2019/2020 janë realizuar temat në vijim në grupet e mëdha dhe atë:

1. Kopshti ynë
2. Tregime vjeshte
3. Familja ime (Trupi im dhe ndjenjat e mija)
4. Magji dimërore
5. Magji dimërore (zakonet dhe festat popullore)
6. Mbretëria e kafshëve
7. Pranvera e luleve
8. Ekologji
9. Ne udhëtojmë
- 10.Çmenduri verore

Në grupin e vogël dhe të mesëm realizohen temat në vijim:

- 1 .Unë në kopsht
2. Vjeshta
3. Shtëpia ime,familja ime
4. Në botë dhe shqisat
5. Dimër ,dimër e po cka
6. I duam kafshët
7. Erdhi pranvera
8. Ne udhëtojmë,komunikacioni

Me realizimin e temës “Unë në kopsht” mundësohet adaptim më i lehtë e veçanërisht ato fëmijë që përherë të parë hyjnë në të, ashtu që mundësohet të realizohen lojna me karakter zbavitës, lëvizshmëri, dramatizim dhe të tjera.

Më këtë temë mundësohet të fëmijët të zhvillohen aftësi për komunikim, si me shokët ashtu edhe me më të mëdhenjtë me qëllim që më lehtë të adaptohet dhe përshtatet me kushtet që i jep kopshti.

Me temën “ Vjeshta” në mënyrë të drejtë do të jenë pjesëmarrës në realitetin për atë që ndodh në natyrë. Organizohet pritja e vjeshtës në vendin e oborrit të qendrës me këngë dhe tekste dramatike. Me realizimin e kësaj teme fëmijët njoftohen me dukuritë meteorologjike, dukuria siç është shiu, bryma dhe të tjera. Këtu zhvillohen ndjenjat për natyrën dhe bukuritë, pasuria për familjen e vet e cila e riedukon të njëjtën.

Me realizimin e temës “ Shtëpia ime ,familja ime” fëmijët njoftohen me vendin ku jetojnë, dhomat dhe funksioni i tyre, me anëtarët e familjes më të ngushtë dhe më gjerë. Zhvillohet dashuria për familjen, nëpërmes tregimeve, dramatizimeve dhe trungut familjar.

Me afrimin e stinës së dimrit hyn në realizimin e temës “ Dimri “. Përpunohet vjersha “ Dimri “, përralla “ Era e Veriut “, tregimi “ Fëmijët dhe bora” dramatizimi i tekstit “, “ Në vigjilje të Vitin e Ri”. Nëpërmes të këtyre përmbajtjeve të fëmijët pasurohet fjalori, zhvillohet fantazia, të mbajturit mend, të menduarit dhe të tjera.

Për festën e Vitit të Ri organizohen shfaqje me qëllim për pritjen e Baba Dimrit, që të jetë në mënyrë sa më solemne. Po ashtu fëmijët ishin njoftuar për zakonet kombëtare: kolendrat, kërsëndellat, (vasilica), etj.

Qëllimi i kësaj teme ishte që fëmijët të njoftohen me kafshët shtëpiake, kafshët e egra në Kopshtin zoologjik. Pastaj u përdorën edhe fletushkat e ilustruara: “Kozeta Bellaka”, “ Ujku dhe shtatë edhat”, “Ujku dhe dhelpira”, “ Lepuri i kaltër”, “ Tre derrkucët”, “ Marika në kopshtin zoologjik” e tjerë.

Qëllimi i kësaj teme ishte që fëmijët të njoftohen me këto kafshë, të munden ti dallojnë dhe të emërojnë.

Ardhja e pranverës manifestohet në mënyrë solemne me vjersha, këngë, drama, me këtë fillon edhe realizimi i temës “ Pranvera e luleve”. Janë bërë më shumë shëtitje në natyrë me qëllim që tema të jetë sa më afër fëmijëve.

Në temën “ Ne udhëtojmë” u realizuan disa shikime ku fëmijët u njoftuan me rrugën, kalimin e këmbësorëve, udhëkryqin, semaforin, parkingjet dhe të ngjashme. Me atë të fëmijët zhvillohet ndjenja për sjelljen e drejtë për të gjithë dhe po ashtu që pajisen me kulturë të komunikacionit. Organizohet shëtitje me autobus deri te shëtitorja e parë te vendi Krushinë ku fëmijët do të kalojnë një ditë të bukur në sipërfaqe të gjelbër.

Me temën: “Çmenduri verore ” e mbarojmë vitin shkollor, që do të thotë se fëmijët njihen me kohën vjetore verën e cila është njëra prej më të dashurave të stinëve të vitit.

Gjatë tërë vitit fëmijët nëpër mes të aktivitetëve të ndryshme njoftohen nëpër mes të mendimit të botës së matematikës. Qëllimi i kësaj teme ishte që fëmijët të njoftohen me mendimin siç janë: mendimi për çiftet, krahasimi i madhësive, krahasimi i objekteve dhe lëndëve, të manipulojnë me numrat deri në dhjetë, me masat për matjen e gjatësisë, peshës, si dhe me monedhat si mjet pagese, si dhe me orën, e cila e mat kohën.

Prej shkencave pedagogjike dhe psikologjike dihet dhe pranohet roli primar i familjes si mësues dhe pedagog i parë. Për atë qëllim ishin të kyçur edhe prindërit në të gjithë aspektet në procesin edukativo arsimor në qëndron parashkollor. Eshte organizuar seminar për prindërit dhe e të qenit prind në mbrojtje të UNICEF ,dhe janë organizuar puntori (per vitine ri,për pranverën ,festën e Pashkëve dhe festën e Bajramit).

Në të gjitha grupet edukuese dhe nëpërmes të gjithë temave edukativo-arsimore përmbajtjet dhe aktivitetet fëmijët arrijnë me: shprehi kulturor-higjienike, që është shumë e rëndësishme për shëndetin e tyre, mënyra e drejtë e përdorimit të mjeteve higjienike, higjiena personale si dhe arritjet e shprehive kulturore në bazë të aktiviteteve në vendet e punës, si dhe gjatë konsumimit të ushqimit.

-Puna edukative me çdo grup edukues realizohet nëpërmes detyrave dhe temave programore. Përmbajtjet, të cilat ishin të përpunuara kontribuon për zhvillimin të fëmijët, kuptimi për marrje, përcaktimet, mbledhje, përcaktimi i lodrave, kryerjen e detyrave elementare si p.sh. në mbajtje të kujdestarisë në terpezari, në sallat e argëtimit etj.

Nëpërmes këtyre temave të përpunuara fëmijët përfitojnë dijeni në lëmine DNSHM. Veçanërisht mirë u realizua detyra për kultivimin edisponimit të kthjelltë, veçanërisht për festimin e festave. Fëmijët futen nëzbulimin më karakteristik të dukurive të natyrës që të dinë dhe ti përjetojnëbukuritë e tyre.

Në të gjithë grupet edukuese realizohen përmbajtjet nga lëmi e literaturës për fëmijë (tregime, vjersha, tekste artistike në prozë, tekste dramatike, etj).Nëpër mes të këtyre përmbajtjeve programore fëmijët pasurohen me fjalë tëreja që shënojnë cilësi në përjetime, dukuri, zgjohet interesi për vizatimet,

si dhe dashuri për gjuhën letrare, revista letrare dhe të ngjashme.

-Hyrje në matematikë fëmijët janë të përfaqësuar në të gjitha vendet e punës në sallat e argëtimit dhe nëpërmes të gjitha detyrave dhe përmbajtjeve programore. Fëmijët njoftohen nëpërmes të lojave me të gjitha figurat gjeometrike dhe dinë të njëjtat ti emërojnë dhe ti klasifikojnë. Njoftohen me numrat deri në 10 dhe dallimin e numrave. Fletët e punës që përdoren në grupet e mëdha për hyrje në botën e matematikës ishin mirë për punë individuale dhe aftësimi i fëmijëve për punë të mëvetësishme.

- Edukimi i artit figurativ pjesën më të madhe të detyrave programore në të gjitha grupet edukuese mirë realizohet në lëmine e këtij edukimi. Por më mirë detyrat realizohen në lëmine e modelimit, fotografimit dhe vizatimit. Nëpërmes të këtyre përmbajtjeve fëmija zhvillohet në person të gjithanshëm.

-Edukata fizike realizohet në të gjitha grupet edukative. Veçanërisht kryhen detyrat dhe përmbajtjet që sillen për zhvillimin e muskulaturës formimin e drejtë të mbajtjes së trupit dhe zhvillimin e aftësive motorike.

-Edukata muzikore realizohet në të gjitha grupet edukuese ku më shumë kujdes i kushtohet frymëmarrjes së drejtë gjatë këndimit dhe qartë shqiptimi i fjalëve.Përshkak të nevojës për jetesë të përbashkët multikulturore është organizuar koncert-performancë nga ana e grupit Triangl.

Këtë vit shkollorë 2019-2020 ndryshe nga vitet tjera prej datës 11 mars 2020 që u shpallë gjendje e jashtëzakonshme nga ana e Qeverisë së R.M.V. përshkak të pandemisë nga virusi COVID-19 , edukatorët mësimin e kanë mbajtur online dhe janë përpjekur që deridiku të arrinë ta realizojnë programin e paraparë.

6. PËRKRYERJA E KUADRIT PROFESINAL

a) Përkryerja e individit profesional

Në fushën e përkryerjes individuale në këtë vit shkollor janë mbajturseminare nga ana e institucioneve përgjegjëse në temat: “ Roli i edukatorëve tëçerdhës në ndërtimin e personalitetit të

fëmijët”, “ Portreti im për muzeun”, “ Integrimi i edukimit ekologjik në sistemin arsimor maqedonas”, “ Zbatimi i standardeve në përparimin e hershëm të zhvillimit fëmijëror” edhe seminari i mbajtur në qershor “Menaxhimi me burimet njerzore në kopësht-përgaditja e një plani personal për zhvillimin profesional përmes vetë-reflektimit” e mbajtur nga profesor Konstantin Petkovski .

Të gjitha këto kushte për përkryerje të personelit, do të kalojnë te fëmijëtpër dhënien e gjeneratave me nivel të lartë të arsyes nëpërmes të aktiviteteve të llojllojshme të lojave dhe aplikimin çdo ditor në vlerat morale të jetës në edukimin etik të fëmijët e moshës parashkollore.

b) Format e përkryerjes të profesionit në qendër

Zbatohet në të gjitha komponentët bazë të programit nëpërmes përmbajtjeve përkatëse të cilat përgjigjen për zhvillimin e fëmijës, duke kyçur familjen dhe prindërit, duke respektuar afinitetet individuale të fëmijëve dhe mundësisht të njëjtit të bëjnë zgjidhje të aktiviteteve në sallat e argëtimit. Për të ndjekur punën edukative – arsimore dhe realizimin e përmbajtjeve të programit në këtë vit shkollor ishin realizuar format e aktiviteteve në vijim: frontale, grupe dhe forma individuale e punës me fëmijët.

Detyrat programore dhe përmbajtja veçanërisht janë kryer nga lëmi i Matematikës ashtu që fëmijët janë njoftuar me figurat gjeometrike, me numrat natyror, me pllakat logjike dhe me të aftësohen për punë individuale dhe nëpërmes tyre fitojnë shprehje në precizitet, këmbëngulësi dhe qëndrueshmëri në punë.

Fletët e punës të cilat ishin përdorur te grupet e mëdha kontribuuan përpunë individuale ashtu që edukatorët më tepër të jenë kreatorë kurse puna e fëmijëve më shumë të respektohet që të mundet të sundojë interesi dhe aftësitë e fëmijës të grupit. Prej realizimit të formave dhe aktiviteteve dalin detyrat dhe aktivitetet të cilët janë në funksion të përparimit të punës edukative – arsimore.

c) Pjesëmarrja e formave për përkryerje profesionale të kuadrit në qendër

Edhe ky vit shkollor në fushën e përkryerjes profesionale të personelit i jepej një domethënie e madhe. Si formë të përkryerjes profesionale përparakrejt asaj janë mbajtur e mbledhjeve në nivel të këshillit profesional të udhëhequr nga drejtori. Në të gjithë mbledhjet janë bërë analiza për punën e edukative në grupe për çdo muaj, ndjekja e literaturës profesionale dhe pedagogjike, ndjekja e revistave për fëmijë, përgatitja e planeve mujor dhe editor, dhe njëherë shpërndarjen e temave në grupet edukative. Po ashtu si formë për përkryerje profesionale është e paraparë në disa pyetje thelbësore të punës edukative – arsimore si për shembull udhëheqja e evidencës pedagogjike dhe ajo dokumentacionit.

d) Dhënja e provimit për licencë

Kujdesi i kuadrit edukativ në çerdhen e fëmijëve si bashkëpunëtorë profesional me sukses dhan provimin e licenses për bashkëpunëtorë profesional, edukatore dhe përkëdhelës që është e obliguar me ligj sipas ligjit për mbrojtjen e fëmijëve.

7. REALIZIMI I MBROJTJES SHËNDETËSORE

Mbrojtja shëndetësore përbëhet për mbajtjen e higjienës në dhoma, pajisjeve, enëve, shtrujave dhe krejt asaj që mundet të jetë e rrezikshme për shëndetin e fëmijëve.

Bëhet rregullisht dezinfektim, deratizim, dizinsecim nga ana e shërbimit kompetent të komunës me qëllim që të mos vijë deri te efekte të padëshiruar. Po ashtu nga ana e shërbimit epidemiologjik në komunën tonë sidhe motra e medicinës në qendër, ishin edhe kontrollat më të shpeshta dhe njëherë ndërmarrë masat preventive në përputhje me higjienën në përgjithësi.

Motra medicinale rregullisht kontrollon dhe ndikon në mënyrë këshilluese individuale edhe në takime me prindërit.

Kishim edhe bashkëpunim të jashtëm me specialist stomatologë të cilët bënin vizita mjekësore të dhëmbëve të fëmijëve, me këshilla për mirëmbajtje të dhëmbëve.

Patëm edhe vizitë ortopedike dhe skaner për të zbuluar të gjitha deformimet e hershme tek fëmijët me një rekomandim për teste ose ushtrime të mëtejshme.

8. VEPRIMTARIJA KULTURORE NË QENDËR

a) Llojet e bashkëpunimit me prindërit

Veprimtaria e hapur kulturore në periudhën e kaluar është realizuar në shumë forma. Si forma më të rëndësishme është bashkëpunimi me prindërit përcjell me lloj-lloj formash të bashkëpunimit.

Si për shembull: bashkëpunim në përpunimin e përmbajtjes të programit, dekorimin e qendrës dhe të tjera. Interesi nga ana e prindërve ishte i ndryshëm por prapë se prapë mundet të thuhet se ishte në nivel të kënaqur. Prindërit për çdo ditë ishin të njoftuar me jetën e fëmijëve të tyre në kopsht.

Janë mbajtur takime të veçanta me prindërit edhe atë në grupe.

Bashkëpunim ka me të gjitha shkollat fillore të qytetit tonë.

- Bashkëpunimi me të tjera kopshte ka qenë në nivel.

- Bashkëpunimi i kopshtit me institucione profesionale dhe shkencore

ishte në kornizat e mundësive, me e shpeshtë me Ministrinë për punë dhe politikë sociale, Biron për zhvillim të arsimit dhe të ngjashme. Bashkëpunim lokal kemi me muzeun e Maqedonisë perëndimor, pallatin e kulturës, bibliotekën e qytetit dhe të ngjashme.

- Manifestime publike kishim edhe këtë vit, manifestime, shfaqje siç janë: “Festa e patriotit”, “ Viti i Ri dhe pritja e Baba Dimrit”, “ 8 Marsi”, “ Një Prilli”, si dhe festime të festave fetare : kolendra dhe vasilica, Pashket, Krishtlindje, Ramazan Bajrami dhe Kurban Bajrami. Janë mbajtur më shumë aktivitete për shkak të javës së fëmijëve (prej 05-10 Tetor).

9. VEPRIMTARITË SOCIALE

Kujdesi i fëmijëve në kopsht kishte për qëllim fëmijët në kopsht ta ndiejnë si mes ku të gjithë fëmijët kanë të njëjtat mundësi të kyçen në jetën dhe punën pa marrë parasysh gjininë, përkatësinë nacionale dhe kulturore dhe me të arrihet qëllimi social.

Zhvillohen aftësitë për adaptim në mes të ri, marrëdhëniet interpersonale në mes të barabartëve dhe shprehive komunikative. Zhvillohet vetëdija për përkatësinë në marrëdhënie me grupin si dhe zhvillimin e inteligjencës sociale.

Fëmijët zhvillojnë norma dhe adete në mase dhe situata të ndryshme me çka fëmija hynë në vlerat universale të njeriut dhe principet etike.

Aktivitetet e projektit janë : kujdesi i fëmijëve në mesin që u mundëson bredhje, mësim, jetë të përbashkët, shoqërim-pa marrë para sysh përkatësinë nacionale, kyçe dhe stërvitje të prindërve të tyre prej informimeve të ndryshëm dhe tema edukative.

Në këtë vit shkollor ishin të parapamë dhe njëherit të realizuara projektet në vijim:

-humanitaro edukativ projekt “ prej fëmije në fëmijë ”.

Ky projekt fëmijët i mëson qysh në moshën më të vogël për humanistet dhe solidaritet.

-“ Qyteti nëpërmes syve të fëmijëve”.

Zhvillohej dashuri, ndjenja për patriotizëm, respekt, kujdes dhe përgjegjësi për atdheun e vet, dhe për vendlindjen dhe vendin e jetesës.

-Kultivimin dhe konsumimin e ushqimit të shëndoshë- “ kopshte në kopshtet e fëmijëve”.

Nëpërmes këtij projekti përherë sigurohen përmirësime, zhvillime të dijenive dhe ngritjen e vetëdijes që do të thotë për ushqimin e drejtë dhe të shëndetshëm.

-“ Respekti i ndryshimeve dhe multikulturalizmit”

I nxit fëmijët që të njoftohen me ndryshimet në bazë të çdo gjëje dhe ato ti respektojnë. Si dhe njoftimet e përcaktimeve të veta dhe të tjerave kultura në Republikën e Maqedonisë.

10. REALIZIMI I VEPRIMTARISË TË ORGANEVE DHE TRUPAVE, DREJTORIT DHE BASHKËPUNËTORËVE PROFESIONAL

1. Puna e drejtorit në kopshtin e fëmijëve

Puna e drejtorit në punën raportuese përbëhej për realizimin e aktiviteteve të parapara me programin vjetor.

Prej fillimit të vitit shkollor aktivitetet e drejtorit ishin të drejtuar kah sigurimi i kushteve për punë, për realizimin e veprimtarisë bazë, jepja e ndihmës profesionale të punëtorëve profesional, të personelit edukativo- kujdesëm si dhe tërë potencialit punues në qendër me të njëjtin qëllim që sa më me sukses të realizohet plani vjetor.

Drejtori kujdesej maksimalisht në realizimin dhe përcaktimin e programit si dhe përcaktimet dhe detyrat përmbajtësore, kurse ajo kontribuoi për të arritur rezultate maksimale si në fushën e veprimtarisë edukativo - arsimore po ashtu edhe potencialin e veprimtarisë punuese. Qëllimi i drejtorit ishte i suksesshëm të funksionojë kopshti dhe me të të afirmohet edhe jashtë lokacionit të vet.

Si përgjegjës, rregullisht i mbante të gjitha mbledhjet profesionale me të gjitha aktivet për të cilat më tepër diskutohej për aktivitetet drejtpërdrejt të lidhur me të gjitha punët në IPKKF “ Kopshti i fëmijëve “ Ollga Miceska” Kërçovë.

2. PUNA E PEDAGOGUT

Puna e pedagogut parashkollor është i drejtuar në zgjidhjen konkrete të detyrave edukative – arsimore.

Pedagogu ka të përgatitur plan vjetor për punën dhe në bazë të atij programi i realizon aktivitet e veta nëpër muaj.

Kryen regjistrimin e fëmijëve në kopsht dhe po ashtu formon grupe edukative sipas moshës dhe njësive punuese. Merr pjesë në përgatitjen e programit të vitit në vijim. Së bashku me drejtorin bënë orarin e personelit edukativo – kujdesëm sipas grupeve, bënë ndarjen e materialit të nevojshëm për punë, didaktikën dhe mjetet tjera. Drejton literaturën pedagogjike për fëmijë. I organizon takimet prindërore. Rregullisht koordinon punën për realizim sa më të suksesshëm të programit.

Detyra kryesore e pedagogut ishte që ti nxis dhe ndjek realizimet e detyrave programore.

3. KËSHILLI PEDAGOGJIK – MOTRAT MEDICINALE

Ky këshill punonte për realizimin e qëllimeve dhe detyrave në bazë të programeve të përgatitur më parë të vitit shkollor 2016/2017. Ky aktiv punon në përbërje të motrave të medicinës dhe personelit kujdesëm. Gjatë këtij viti janë mbajtur më shumë mbledhje, njëherë në muaj dhe sipas nevojës e më shpesh në të cilët më tepër diskutohej kujdesi mbrojtjen shëndetësore të fëmijëve, kushtet higjiene – shëndetësore në qendër, higjiene personale e fëmijëve, si dhe për rregullat e ushqimit të fëmijëve.

4. KËSHILLI I EDUKATORËVE

Këshilli profesional i edukatorëve në këtë vit shkollor punonte për realizimin e qëllimeve dhe detyrave për edukimin dhe arsimimin, përparimin e qëllimeve dhe detyrave të edukimit – arsimor si dhe punët pedagogjike. Këshilli i edukatorëve punonte sipas programeve të përgatitur sipas muajve. Çdo muaj rregullisht mbahej mbledhjet a sipas nevojës edhe më shpesh. Në ato mbledhje ai tim i edukatorëve i shikonte pyetjet e fushës programore, zgjedhje të temave dhe realizimi i tyre. Po ashtu në ato mbledhje këshilloheshim (merreshim vesh) për disa pyetje suptile nga lëmi i punës edukativo – arsimore për vizita të institucioneve shoqërore, institucione kulturore, shëtitje dhe piknik në afërsi të rrethit dhe të tjera. Po ashtu i vihej aksent edhe udhëheqjes së evidencës pedagogjike dhe dokumentacionit.

11. POLITIKA MATERIJALE DHE MBAJTJA FINANCIARE

Mjetet për financim për mbrojtje e fëmijëve sigurohen prej Buxhetit të Republikës së Maqedonisë, pagesa e shërbimeve të shfrytëzuesve dhe të tjera burime në pajtim me ligjin.

Me këto mjete financohet:

- të drejtat për mbrojtjen e fëmijëve
- veprimtaria e qendrës publike
- aktivitetet programore të formave të ndryshme për përparim dhe zhvillim të veprimtarisë;
- shërbimet.

Me mjetet për financim për mbrojtjen e fëmijëve udhëheq dhe disponon Ministria dhe Qendra. Mjetet nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë dhe shfrytëzuesve sigurohen në bazë të veprimtarisë të Programit për zhvillim për mbrojtjen e fëmijëve ku është vërtetuar të pamurit, vëllimi, kualiteti dhe përmbajtja e shërbimit, dhe harxhohen rreptësisht për qëllim të caktuar që përpara është përgatitur plan financiar.

Për realizimin e kësaj kujdeset drejtori dhe shërbimi i këtij lëmi.

Materialet harxhues të parapara me planin financiar harxhohen për qëllim të caktuar.

Në bazë të Ligjit për furnizim publik përgatitet Plan për furnizim publik dhe tërësisht do të zbatohet.

Për zbatimin furnizimit publik kujdeset Komisioni për furnizim publik në bashkëpunim me të gjithë personat profesionistë dhe kompetentë.

Me shqyrtimin e këtyre mjeteve më tepër harxhohen për nevojat e fëmijëve në qendër, dhe rreptësishtë mbahet llogari për kualitetin.

Plani për furnizim publik në mvarshmëri të nevojave të qendrës mundet të ndryshojë dhe zgjerohet në pajtim me ligjin.

Për përmirësimin e kushteve të kopshtit tonë këtë vit kemi siguruar donacione nga ,Komuna e Kërçovës,Shoqata Aksionare Centralet Elektrike të Maqedonisë sëVeriut dhe Kombinati centralo-energjik Oslomej KXE-Oslomej, Univerziteti FIX ,NLB Tutunska Banka,Termocentrali i Maqedonisë së Veriut ELEM,Profesor Sreten Milladinoski dhe Doktorësha Aleksandra Avramoska gjithashtu edhe donacion për dhomën sensorike nga Zotri Sheki Ibishi.

Gusht,viti 2020
Kërçovë

IPK-KOPSHTI FËMIJËVE
“ OLLGA MICESKA” KËRÇOVË”

Drejtori

Sadik Ahmeti